

SUPERBETON Shpk

Tiranë

VENDIM

I

ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Sot më 10 Mars 2017, në orën 13.00, në selinë e Shoqërisë Superbeton shpk, pas diskutimeve lidhur me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pronare kuotës shtetërore në shoqërinë Superbeton shpk, për transferimin e kuotës shtetërore nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes tek Bashkia e Tiranës, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nenet 73 dhe 81 si dhe në Statutin e shoqërisë, me propozim të ortakut shtetëror, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, me unanimitet,

VENDOSI

1. Të aprovojë transferimin e kuotës shtetërore nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes tek Bashkia e Tiranës.
2. 2- Transferimi i pronësise nga MZHETTS tek Bashkia Tirane, do te kryhet pas miratimit te Vendimit te Keshillit te Ministrave dhe botimit ne Fletoren Zyrtare.

Për ASAMBLENE E PERGJITHSHME

Përfaqësuesi i Euroteorema s.r.l

Përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Zj. Klarita REXHEPAJ

(Marilena Pascale)

EUROTEOREMA s.r.l
Via Avogadro 19 - 10121 TORINO
C.F. e P.IA IVA 06494880013

SUPERBETON Shpk

Tirane

PROCES VERBAL

I

MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot më 10 Mars 2017 në orën 13.00, në selinë e Shoqërisë Superbeton shpk, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, për të diskutuar e vendosur sa më poshtë:

Rendi i ditës

- Aprovimi i Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor 2016
- Transferimi i kuotave shtetore ne pronesi te Bashkise Tirane, motivet dhe qellimi
- Të ndryshme

Me propozim unanim te te pranishmeve , merr kryesine e Asamblese Administratori i Shoqerise z.Giovanni Pascale i cili cakton me detyren e Sekretarit znj.Lirije Kacori.

Kryetari i Asamblese,

Konstaton qe,

- Përvec atij vete jane janë të pranishëm Administratori tjetër i shoqerise z.Hidajet Raklli, perfaqesuesi i Shoqerise Audituese, Albanian Audit Partners shpk (AAP), z.Dashnor Carcani, si dhe i gjithë kapitali i shoqerise në personat:
- Znj. Marilena Pascale, përfaqëuese i Ortakut EUROTEOREMA S.r.l, zotëruese e 70% të kapitalit të shoqërisë, dhe
- Znj. Klarita Rexhepaj, përfaqësuse e Ortakut shtetëror, sipas Autorizimit Nr.1537/1 Prot, datë 03.03.2017, lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes , zotërues i 30% të kapitalit të shoqërisë,
- Asambleja eshte thirrur rregullisht me njoftim marrje te ortakeve me date 23.02.2017,

Duke konsideruar qe

te pranishmit deklarojne te jene mjaftushmerisht te njohur per ceshtjet e Rendit te dites dhe nuk kane probleme per te ngritur

deklaron

Asamblenë e Përgjithshme te Ortakeve rregullisht të mbledhur dhe të aftë për të diskutuar e vendosur për rendin e ditës

Kalohet ne diskutimin e pikes së parë të rendit të ditës, aprovimi i pasqyrave financiare te vitit 2016 dhe destinimi i rezultatit të vitit. Drejtuesi i mbledhjes i kujton ortakeve se ata jane njohur paraprakisht me Pasqyrat Financiare te vitit 2016 dhe me Raportin e Eksperteve Kontabel te Regjistruar lidhur me keto pasqyra.

E merr fjalën znj. Klarita Rexhepaj, e cila paraqet Autorizimin Nr. 1537/1Prot., datë 03.03.2017 dhe përcjell qëndrimin e Ortakut shtetëror për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin ushtrimor 2016, sipas shkresës Nr. 1537/2 Prot, datë 03.03.2017, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes.

Administratori i Shoqërisë Hidajet Rraklli, pasi bën një përmbledhje të aktivitetit të Shoqërisë gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe veshtirësitë e hasura, të cilat janë trajtuar edhe në Raportin e Administratorit, jep sqarime për të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatin financiar si dhe aspekte të tjera të lidhura me këta tregues, duke i përmbledhur si me poshte:

- Të ardhurat nga veprimtaria kryesore.....	10,280,000 lekë
- Te ardhura te tjera.....	911,854 lekë
- Shpenzimet për veprimtarinë kryesore.....	- 18,204,626 lekë
- Të ardhura/shpenzime financiare.....	- 56,273 lekë
- Rezultati bruto i vitit (Humbje)	- 7,069,045 lekë
- Shpenzime te panjohura per tat. fitimin.....	9,966,594 lekë
- Fitimi i tatueshem.....	2,897,549 lekë
- Tatim mbi fitimin (15%)	434,632 lekë
- Humbja e bilancit.....	- 7,503,677 lekë

Ai propozon qe humbja e vitit 2016, në shumën prej 7,503,677 lekë, të mbartet ne bilanc per tu mbuluar me fitimet e viteve ne vazhdim.

Përfaqësuesi i shoqërisë audituese AAP, z.Dashnor Carcani, sqaron rregullshmërinë e përgatitjes së pasqyrave financiare të shoqërisë Superbeton shpk për vitin 2016 dhe opinionin e përgjithshëm, të shprehur në Raportin e Auditimit, hartuar nga Albanian Audit Partners shpk.

E merr fjalën Perfaqesuesi i ortakut Euroteorema srl, i cili shpreh shqetesimet e tij per nje ecuri jo te kenaqshme te shoqerise lidhur me treguesit e vitit

Pas informimeve dhe diskutimeve si më sipër, Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI

1. Të miratojë Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2016
2. Të miratojë rezultatin me humbje te shoqërisë për vitin ushtrimor 2016, në shumën 7,503,677 lekë.
3. Të mbarte ne bilanc humbjen ne shumen prej 7,503,677 lekë, për tu mbuluar me fitimet e viteve te ardhshme.
4. Të miratojë raportin e Ekspertit Kontabel të Regjistruar mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2016 dhe të riemërojë si Ekspert Kontabël të Regjistruar për vitin 2017 shoqërinë audituese Albanian Audit Partners sh.p.k, Tiranë.

Duke kaluar ne piken e dyte te rendi te te dites e merr fjalën znj. Klarita Rexhepaj, e cila paraqet Autorizimin Nr. 1537/1Prot., datë 03.03.2017 dhe përcjell qëndrimin e Ortakut shtetëror

-i cili miraton transferimin e kuotes shteterore ne pronesi te Bashkise Tirane

-transferimi i pronesise nga MZHETTS tek Bashkia Tirane, do te kryhet pas miratimit te Vendimit te Keshillit te Ministrave dhe botimit ne Fletoren Zyrtare.

,sipas shkresës Nr. 1537/2 Prot, datë 03.03.2017, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes.

E mer fjalën znj.Marilena Pascale, perfaqesuese ortakut Euroteorema srl e cila ne mungese te informacionit mbi motivet dhe qellimin e ketij transferimi kuotash, konsideron se Shoqeria Superbeton, ne kushtet e pamundesise per te ushtruar aktivitetin sipas objektit social te saj, duke qene nen juridiksionin e Bashkise Tirane dhe me ortak Bashkine Tirane, mund dhe duhet te optimizojë resurset ne destinacione ne interes te perbashket te Ortakeve te saj edhe ne kuadrin e Partneritetit Publik Privat. Duke konsideruar te mireqene nje objektiv te tille i cili do te jete objekt i sqarimit dhe shtjellimit te metejshem te ketij destinacioni me Bashkine Tirane, ajo jep miratimin e transferimit te kuotave shteterore Bashkise Tirane.

Pas diskutimeve Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI

- 1- Miratimin e transferimit te kuotes shteterore ne pronesi te Bashkise Tirane
- 2- Transferimin i pronesise nga MZHETTS tek Bashkia Tirane, do te kryhet pas miratimit te Vendimit te Keshillit te Ministrave dhe botimit ne Fletoren Zyrtare.

Duke mos patur asgjë tjetër për të diskutuar e vendosur dhe asnjëri nuk e merr fjalën, mbledhja u mbyll rreth orës 14.30, përveç shkrimit, leximit dhe nënshkrimit të këtij procesverballi.

Sekretari

Lirije Kaçori



Për ASAMBLENE E PERGJITHSHME

Përfaqësuesi i Euroteorema s.r.l.

Marilena Pascale

EUROTEOREMA s.r.l.
Via Avogadro 19 - 10121 TORINO
C.F. e P.ta IVA 06494880013

**Përfaqësuese e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**

(Klarita Rexhepaj)





REPUBLIKA E ALBANIË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 1537 / Prot.
12

Tiranë, më 3. 3. 2017

Lënda : Qëndrimi që do të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në shoqërinë "Superbeton" shpk Tiranë.

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 85 "Përfaqësimi në asamble", Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me cilësinë e Ortakut Shtetëror në shoqërinë "Superbeton" shpk Tiranë, në mbledhjen e datës 10.3.2017, ora 13.00, mban qëndrimin si më poshtë:

- Miraton pikën 1 të rendit të ditës "Aprovimin e pasqyrave financiare të vitit 2016".
- Miraton pikën 2 të rendit të ditës "Transferimin e kuotave shtetërore në pronësi të Bashkisë Tiranë".
- Transferimi i pronësisë nga MZHETTS tek Bashkia Tiranë, do të kryhet pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MILVA EKONOMI

**VENDIM****Nr. 362, datë 26.4.2017**

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NR. 5758 PROT., DATË 25.4.2017, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ADMIRAL SPORTWETTEN”, GMBH, “ATSI”, SPOLKA AKCYJNA, “MC NETWORKING”, SH.P.K., “PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT QENDROR TË MONITORIMIT *ON-LINE* (SQMO) PËR INDUSTRIJË E LOJËRAVE TË FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 12, të nenit 70, të ligjit nr. 155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 647, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të kriterëve të përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës nr. 5758 prot., datë 25.4.2017, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të shoqërive “Admiral Sportwetten”, GmbH, “ATSI”, Spolka Akcyjna, “MC Networking”, sh.p.k., “Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) për industrinë e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 364, datë 26.4.2017**

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 30 PËR QIND TË KUOTAVE TË SHOQËRISË “SUPERBETON”, SH.P.K., TIRANË, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 30 për qind të kuotave të shoqërisë “Superbeton”, sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Bashkisë Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 365, datë 26.4.2017**

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE “ARKIVI DIGJITAL I ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave



SUPERBETON SH.P.K.



**VENDIM NR.2
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Sot më 25.06.2019, në orën 11:00, në Seline e Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë,

Vendosi

- Të miratojë shitjen e 231,105 pjeseve nga kapitali i ortakut "Euroteorema" SRL, te cilat perkojnë me 19% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë "Superbeton" shpk, në favor të administratorit Z. Gerti Nushi ose një shoqërie të zotëruar 100% nga ky i fundit sipas vendimit të tij.
- Ngarkohen administratorët të njoftojnë zyrtarisht ortakët për vendimet e marra sot në asamble të përgjithshme.

Për ASAMBLENE E PERGJITHSHME

**Përfaqësuesi i Euroteorema s.r.l.
Angelica Pascale**



DHOMA E NOTERISE TIRANE


NOTER

GJERGJ KONGOLI

Pulla e taksës

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr 2929 Rep.
Nr 1037 Kol



KONTRATE SHITJE KUOTASH TE SHOQERISE "SUPERBETON" SHPK

Sot, me datën 05.08.2019 (dymije e nentembehjete), perpara meje noterit Gjergj Kongoli, anetar i Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Tirane Rr. Kont Urani, Nr 51/I, u paraqiten personalisht palet:

Shoqeria **Bran Development shpk**, me adrese ne Tirane prane Pajtoni Business Center, kati 5, e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT: L91918018D, përfaqësuar nga Z. Gerti Nushi, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë më 23/11/1985, dhe banues në Tiranë, me numër ID 028206513 dhe n. Personal I51123043B, në cilësinë e administratorit, madhor dhe me zotësi të plotë ligjore për të vepruar (**Blerësi**)

dhe

Shoqeria **Euroteorema Srl**, me seli ligjore të regjistruar në Torino, Via Ettore De Sonnaz Nr 14, C.F. e P. Iva 06494880013, regjistruar në Regjistrin e Kompanive në Torino, Itali me numrin 06494880013, përfaqësuar nga Angelica Pascale, e bija e Giovanni, lindur në Torino, Itali, më 09.11.1992 dhe banuese në Rivarolo Canavese (TO), Corso Indipendenza Nr 163 identifikuar me pasaportën N. YB1648975 me kompetencat e dhëna nga statuti dhe Asamblea e Aksionarëve të Shoqërisë më 21.06.2019 (**Shitësi**), në vijim e sipër referuar si palët,

Duke patur parasysh që:

- Shoqeria **Euroteorema Srl** është pronare e 70% të aksioneve të Shoqërisë Superbeton sh.p.k. me seli në Rruga "5 Maji", Tirane, me NIPT: J61901079J, që përbejnë një numër prej 851,438 kuotash (tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e tetë aksione) të kapitalit aksionar të Superbeton shpk.
- Shoqeria **Euroteorema Srl** ka vendosur të shesë një pjesë të kuotave të saj të zotëruara në shoqërinë Superbeton shpk, të barabartë me 19% të kapitalit aksionar të përgjithshëm të Superbeton shpk.
- Shoqeria **Bran Development shpk** ka vendosur të blejë kuotat e sipërpermendura të barabarta me 19% të kapitalit aksionar të përgjithshëm të Superbeton shpk.

Nisur nga sa më sipër, palët e paraqitura dakortësojnë dhe nënshkruajnë sa vijon:

1. Shoqeria **Euroteorema Srl**, i shet shoqërisë **Bran Development shpk** e cila i pranon, një numër prej 231,105 kuotash (dyqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e pesë aksione) nga pjesëmarrja e saj në kompaninë Superbeton shpk, që përbejnë 19% të totalit të kapitalit aksionar të shoqërisë Superbeton shpk.



DHOMA E NOTERISE TIRANE

NOTER

GJERGJ KONGOLI

2. Cmimi i dakorduar dhe pranuar nga palët për shitjen është 120,000 euro (njqind e njezet mije euro), qe e perkthyer sipas kursit te kembimit te dites se sotme eshte 14,490,000 lekë (katërmëdhjetë milion e katërqind e nentëdhjetë mije lekë) për totalin e kuotave te lartpërmendura.
3. Palet deklarojne se ne percaktimin e cmimit eshte marre parasysh kontributi profesional i pales blerese, si dhe suporti per operimin dhe zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.
4. Pagesa e cmimit te percaktuar ne piken 2. mund të bëhen në një ose më shumë këste në favor të shitësit, dhe shuma totale duhet të paguhet brenda dhe jo më vonë se data 31.12.2019. Mbi shumatat e shtyra do aplikohet interes vjetor prej 2.5% ne vit. Palet gjithashtu dakortesojne se principlali dhe interesi potencial i pagueshem per cmimin e dakortesuar eshte i rinegociueshem.
5. Shitesi deklaron se kuotat e shitura janë në pronësi dhe disponibilitet të plotë të tij, te pa shitur deri me tani, nuk janë lene peng, dhe nuk jane objekt sekuestrimi apo i bllokimeve të ndryshme. Gjithashtu shitesi deklaron se i eshte bere njoftimi paraprak ortakut tjeter, sipas normave dhe neneve te statutit te shoqerise.
6. Shitësi deklaron se taksa për këtë shitje do të llogaritet dhe paguhet prej tij në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar sipas ligjit Italian.
7. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi heq dorë nga të drejtat e tij për aksionet qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe blerësi gëzon të gjitha të drejtat ne vijim.
- 5) Shitësi dhe blerësi marrin përsipër të garantojnë përmbushjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale.

Kjo kontratë është hartuar në katër kopje identike dhe origjinale. Sa me siper u hartua nga noteri, dhe pasi u lexua me zë te larte shitësit dhe blerësit, u nënshkrua rregullisht prej tyre, dhe une Noteri vertetoj firmat e tyre konform ligjit.

SHITËSI

Euroteorema SRL

Znj. Angelica Pascale

BLERËSI

Bran Development shpk

Z. Gerti Nushi

NOTER

Gjergj Kongoli

Ne prani te perkthyeses



Kursi zyrtar

Periudha kohore	05.08.2019 - 05.08.2019
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)
Data	Lekë për njësi të monedhës së huaj
05.08.2019	120.75